

Numri i lëndës: 2019:250780

Datë: 10.01.2024

Numri i dokumentit: 05170220

P.nr.506/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – dega V., Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtares së vetme gjykuese Blerina Jakupi Ramadani, me bashkëpunëtorin profesional Fitim Limani, në çështjen penale ndaj të pandehurit L.A., nga fshati B., Komuna V., për shkak të veprës penale ndërtimi pa leje nga neni 359 paragrafi 3, lidhur me paragrafin 2 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP.II.nr.1815/2019, e datës 23.12.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik me datë 27.12.2023, me datë 28.12.2023, në mungesë të palëve mori, shpalli publikisht, kurse me datë 10.01.2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **L.A.**, nga babai A., nëna M., e lindur Lutfiu, i lindur me datë 11.09.1991 në Gjilan, me vendbanim në fshatin B., Komuna V., i martuar, baba i tre (3) fëmijëve, ka të kryer magjistraturë në lëndën e historisë, profesor i gjuhës frënge dhe i historisë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal 1176624333, lëshuar nga MPB-Prishtinë, Republika e Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

I

Sepse, me datë 08.09.2019, deri me 30.09.2019, në V., në rrugën “ F.J.”, përball Shkollës Teknike, nga Inspektorët e Ndërtimit të Komunës së V.së, kanë konstatuar se i pandehuri L.A. si pronar, investitor dhe përgjegjës i drejtpërdrejtë ka ndërmarrë veprime që bien ndesh me nenin 14, pika 1.4 të Ligjit 04/L-110 mbi Ndërtimin, ashtu që ka filluar mbindërtimin e objektit ekzistues banesor kolektiv në rrugën e lartcekur pa u pajisur paraprakisht me leje ndërtimore, si dhe nuk ka respektuar aktvendimin e inspektorit të Drejtorisë së Inspektoratit Komunal në V., me nr. 08. 38/2019, të datës 09.09.2019, për ndërprerje dhe pezullim të punëve, por ka vazhduar ekzekutimin e punëve pa ndërprerë në mbindërtimin e objektit afarist dhe atë pa i përfill dispozitat ligjore për t’u pajisur me leje ndërtimi, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e tij të kundërligjshme ka rrezikuar sigurinë e përgjithshme që kanë të bëjnë me rregullat e ndërtimit.

-me këtë veprim ka kryer veprën penale ndërtim pa leje nga neni 359 paragrafi 3, lidhur me paragrafin 2 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 7, 17, 38, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, si dhe nenit 242 dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të pandehurin L.A.:

E G J Y K O N

Ashtu që të pandehurit L.A. për veprën penale të përshkruar në dispozitivin **I** të këtij aktgjykimi i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas ditës pasuese të plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe dënim me gjobë në vlerë prej **400.00 (katërqind) €**, të cilin dënim obligohet i pandehuri ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 44 të KPK-së, me pëlqimin e të pandehurit, dënimi me burgim i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej **2.500,00 € (dymijë e pesëqind euro)**, të cilin dënim obligohet i pandehuri ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri i lartcekur nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, atëherë gjykata do t'ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të barazohet me 20€ (njëzetë euro) të dënimit me gjobë.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20€ (njëzet) dhe shumën prej 20€ (njëzet) euro për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

E dëmtuara Komuna e V.së-përfaqësuesi i saj për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

Konform nenit 362 paragrafi 1 pika 1.1 të KPPRK-së:

REFUZOHET AKUZA

II

Sepse, me datë 09.09.2019, rreth orës 10:00 minuta në V., në punishten e quajtur “Te shkolla e Mesme Teknike”, në afërsi të rrugës “ F.J.” në Z.K. të V.së, si person përgjegjës i projektimit, mbikëqyrjes dhe kryerjes së punëve ndërtimore për ndërtim të objektit B+P+4 ka vepruar në kundërshtim me standardet profesionale, përgjithësisht të pranuar, kushtet e lejes së ndërtimit dhe nenin 8 paragrafi 1.4, të nenit 14 të Ligjit 04/L-110 mbi ndërtimin, në atë mënyrë që pasi i përfundon punët rreth ndërtimit të objektit të përmendur për të cilin kishte marr leje, vazhdon t'i kryej pa leje edhe disa punë të tjera rreth mbindërtimit +3k+PN, mbi atë objekt, me ç'rast hetohet nga Inspektorati i Ndërtimit të Drejtorisë së Inspektoratit të Komunës së V.së dhe të njëjtit, me aktvendim i urdhërohet që t'i pezulloj – ndërpret ndërtimin e mëtutjeshëm mbi atë objekt sepse për një veprim të tillë nuk kishte leje.

-me këtë kishte për të kryer veprën penale punimet ndërtimore të kundërligjshme nga neni 360 paragrafi 1 të KPRK-së.

Për arsye se gjatë fazës së shqyrtimit fillestar, prokurorja e shtetit është tërhequr nga aktakuza.

E dëmtuara Komuna e V.së-përfaqësuesi i saj për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës për pjesën refuzuese të këtij aktgjykimi bien mbi barrën e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 29.10.2019, në Gjykatën Themelore në Gjilan, Dega në V. ka dorëzuar aktakuzën me numër PP.II.nr.1586/2019, të datës 24.10.2019, për shkak të veprës penale punimet ndërtimore të kundërligjshme nga neni 360 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe me datën 24.12.2019 ka dorëzuar aktakuzën tjetër me numër PP.II.nr.1815/2019, të datës 23.12.2019, për shkak të veprës penale ndërtimi pa leje nga neni 359 paragrafi 3, lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së, ndaj të pandehurit L.A. nga fshati B., Komuna e V.së.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, në seancën e shqyrtimit fillestar, të mbajtur me datën 27.10.2023, pas propozimit të prokurores së shtetit ka marr aktvendim me të cilin i ka bashkuar lëndët sipas aktakuzave PP.II.nr.1586/2019, e datës 24.10.2019 dhe PP.II.nr.1815/2019, e datës 23.12.2019 dhe ka nxjerr aktvendim për bashkim të lëndëve P.nr.506/2019, të datës 27.10.2023. Në këtë seancë i pandehuri ka pranuar fajësin për veprat penale dhe me aktvendim është aprovuar pranimi i fajësisë për të pandehuri L.A.. Shpallja e aktgjykimit nuk është bërë pasi që gjyqtarja ka vërejtur se duhet të sqarohet çështja.

Me datë 27.12.2023, gjykata e ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar dhe publik, në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, përfaqësuesi i të dëmtuarës Komuna e V.së Ekrem Shabani, mbrojtësi i të pandehurit i caktuar sipas detyrës zyrtare, Av. Limon Emini dhe i pandehuri L.A.. Para leximit të aktakuzës, prokurorja e shtetit ka bërë rikualifikimin e veprës penale ndërtim pa leje nga neni 359 paragrafi 3, lidhur me paragrafin 2, lidhur me nenin 77 nga aktakuza me numër PP.II.nr.1815/2019, e datës 23.12.2019, si dhe ka bërë përmirësimin e kohës se kryerjes së veprës penale e cila duhet të jetë me datën 08.09.2019 e deri me datën 30.09.2019 e në vazhdim. Kurse ka deklaruar se heq dorë nga aktakuza me numër PP.II.nr.1586/2019, e datës 24.10.2019.

Andaj, pas krijimit të këtyre rrethanave, dhe pas leximit të aktakuzës me numër PP.II.nr.1815/2019, të datës 23.12.2019, nga ana e prokurores së shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata, pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPP-së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë ndaj të pandehurit L.A. për veprën penale si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, pranimi i fajësisë nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza me numër PP.II.nr.1815/2019 dhe atë:, procesverbali nga Drejtoria e Inspektoratit-Inspektori i ndërtimit me numër të protokollit 53/2019, i datës 09.09.2019, procesverbali me numër të protokollit 56/2019, i datës 23.09.2019, aktvendimi nga Drejtoria e Inspektionit –Sektori i ndërtimit me 08.nr.38/2019, i datës 09.09.2019, procesverbali me numër të protokollit 60/2019, i datës 30.09.2019, procesverbali me numër të protokollit 59/2019, i datës 25.09.2019 një fotografi nga vendi i ngjarjes, si dhe shkresat e tjera në lëndë dhe se aktakuza nuk përmbanë ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri L.A. ka kryer veprën penale ndërtim pa leje nga neni 359 paragrafi 3, lidhur me paragrafin 2 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenin 242 paragrafi 2, pika 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit dhe të njëjtit për veprën penale të përshkuara si në piken e I-rë të dispozitivit të këtij aktgjykimi i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas ditës pasuese të plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe dënim me gjobë në vlerë prej **400.00 (katërqind) €**, të cilin dënim obligohet i pandehuri ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 44 të KPK-së, me pëlqimin e të pandehurit, dënimi me burgim i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej **2.500,00 € (dymijë e pesëqind euro)**, të cilin dënim obligohet i pandehuri ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të

pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij, faktin se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, i pandehuri më parë nuk ka qenë i dënuar, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh faktin se kjo vepër penale është kryer me dashje, shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, rrezikshmërinë që paraqet vepra penale, përkundër që i pandehuri e ka ditur se nga inspektorët komunal të ndërtimit i janë ndërprerë punimet në objekt për shkak se nuk ka pasur leje për mbindërtim, i njëjti ka vazhduar të ndërtoj, andaj edhe mbi të lartcekurat gjykata konsideron se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit të lartcekur duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura si më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

5.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit , gjykata, duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta obligojë ti paguajë shpenzimet procedurale, paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzet) € dhe 20 (njëzet) €, për viktimat e krimit konform nenit 39 par. 3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave, në afat prej 15 ditëve pas ditës pasuese të plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

6.Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, duke e udhëzuar palën e dëmtuar në kontest civil, pasi që nga të mbledhurat në këtë procedurë nuk kemi bazë të sigurt për gjykim të plotë apo të pjesërishtë të dëmit të shkaktuar në këtë çështje penale.

Sa i përket pikës II të dispozitivit të aktgjykimit, gjykata ndaj të pandehurit Leotrim Ahmeti, ka marrë aktgjykim refuzues, në lidhje me veprën penale punimet ndërtimore të kundërligjshme nga neni 360 paragrafi 1 të KPRK-së, pasi që prokurorja e shtetit Leonora Kadriu në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datën 27.12.2023, ka hequr dorë nga aktakuza me numër PP.II.nr.1586/2019, e datës 24.10.2019, duke deklaruar se pas vlerësimit të provave ka vërejtur se në të dy rastet janë provat e njëjta dhe atë: procesverbali i datës 09.09.2019, me numër 53/2019, të lëshuar nga Drejtoria e Inspektoratit Komuna e V.së, Inspektori i Ndërtimit, aktvendimi për pezullimin (ndërprejjen) e ndërtimit të mëtejshëm të mbindërtimit me numër 08. nr. 38/2019, i datës 09.09.2019, procesverbali i datës 23.09.2019, me numër 56/2019, të lëshuar nga Drejtoria e Inspektoratit Komuna e V.së, Inspektori i Ndërtimit. Prokurorja gjithashtu ka theksuar se provat e tjera të cilat i janë bashkangjitur aktakuzës me numër PP.II.nr.1586/2019, të datës 24.10.2019, janë edhe procesverbali i datës 25.09.2019, me numër 59/2019, të lëshuar nga Drejtoria e Inspektoratit Komuna e V.së-Inspektori i Ndërtimit dhe dy fotografi të ndërtimit pa leje, janë në vazhdimësi në të dyja rastet. Andaj ka theksuar se duke u bazuar në provat e paraqitura, shihet se është i njëjti rast.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura, gjykata konform nenit 364 paragrafi 1 dhe nenin 362 paragrafi 1 pika 1.1 të KPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – dega V.
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.506/2019, me datë 10.01.2024**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Blerina Jakupi Ramadani**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.